




**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL IV/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IV (katërtë) për vitin 2026 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.04.2026
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Flamur Bytyçi
z. Enver Shabani
znj. Mimoza Bajraktari
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Laureta Tafaj
z. Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për DKA-në;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin e komisionit për shqyrtimin e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjes “13 Qershori” ;**
- 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për rishqyrtimin e vendimit 01-Nr-410-9873;**
- 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për rishqyrtimin e vendimit 01-Nr-410-9874;**
- 10. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2026;**

Kryesuesi-përshendet të pranishmit, i njofton me rendin e ditës dhe për një pikë shtesë e cila ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit me Nr-016-9866 një vendim i cili është miratuar në Asamble për Zonën Industriale në Shirokë dhe në Samadrexhë.

Flamur Bytyçi-përshendetje për të gjithë,pajtohem që kjo pikë me hy në rend të ditës përshkak që vendimi qysh e kemi thënë edhe në Seancë është i jashtë ligjshëm.

Kryesuesi-e hedhë në votim rendin e ditës me pikën shtesë

6 për,0 kundër,1 abstenim miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 2 .Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin.

Laureta Tafaj-përshendetje për të gjithë,sa i përket këtij projektvendimi ne vazhdimisht kemi dhën rekomandime dhe kena kërku qe mos me u bë punët shkel e shko por nuk është që na ka ndëgjju dikush për atë qka kemi thën dhe mendoj që në këtë rast është dëmtu edhe investitori edhe Komuna,nëse vjen në Asamble ju kisha lut që mos të ndodh si herave të tjera me gjetë vrejte dhe prap me u zhagu këto pun por le të vjenë e mirëfillt ashtu siq duhet dhe le të votohet dhe të miratohet.

Flamur Bytyçi-unë kërkoj me qenë Drejtorat prezent sepse un kam pyetje për këtë çështje nuk e kam të qartë a është një pjesë ku ne e kemi kalu në Kuvend.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj- pas konsultimeve me disa qytetarë të Studenqanit,disa prej tyre jan shumë kundër këtij gurëthyesi sepse po dëmtohen shumë qytetarët prandaj edhe ne nuk e mbështesim këtë projekt-vendimt dhe jemi kundër.

Dardan Berisha-përshendetje për të gjithë,lejen për minim e të gjitha këto i jep Ministria ne e ndajmë vetëm parcelen,mua më kujtohet në legjislaturën 2017/21 kemi qenë kundër qdo herë të dhënjes në shfrytëzim të parcelës për gurëthyes,unë si anëtar i këtij Komision unë e percjelli në Seancën e rregullt por duhet me diskutu dhe duhet me qenë prezentë edhe Drejtori për me dhën sqarime më të rëndësishme spse aty po dëmtohen shumë banorë për rreth,ne i kemi edh fotografit 2018/19 kur kemi qenë kundër dhënjes në shfrytëzim për gurëthyes ku

edhe banorët kan pas një far lloj proteste për mos me dhën në shfrytëzim por ja qe ne po i dëmtojmë më shumë banorët.

Sanie Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë,te projekt-vendimi kur po jepet për shfrytëzim tek destinimi ne e kemi parasysh që ne e kemi një dokument që lëshohet prej Drejtorisë së Urbanizmit që tregon qfar destinimi ka qajo zonë,ku në projekt-vendim po shkruan vetëm për nevoja biznesore dhe mua po më duket shumë e përgjithshme dhe jo konkrete dhe po të lë me mendu qka ka me punu në atë pjesë përderisa destinimi është shumë i qartë pse edhe projekt-vendimi nuk është kaq i qartë,ka edhe zona aty që janë të banimit dhe zona turistike pse nuk po largohen nga ky projekt-vendim përshkak se po supozojmë një biznes e merr për nevojat e biznesit për gurëthyes ai nuk mundët aty edhe me ndërto shtëpi ose me zhvillu një zonë retroaktive turistike destinimin që ish veqë në atë pjesë,pse nuk është destinu pjesa që është për atë destinim dhe me

na tregu konkretishtë qka ka me u bë në atë pjesë se komisioni kur formohet në si Kuvend duhet me i tregu me fillim se për qfarë jemi tu e dhën në shfrytëzim,pajtona me Dardanin për shqetësimin e banorëve të asaj pjese jo vetëm nga dëmtimet por edhe nga mënyra e jetesës,pluhrit kështu që për këtë pikë abstenojë.

Kryesuesi- e hedhë në votim

4 për,1 kundër,2 abstenime miratohet

Pika 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për DKA-në;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-para se me dërgu në Asamble me tregu pse gati të gjitha Shkollat në Suharekë nuk kan Drejtorë psh në Shkollën Samadrexhë,Shirokë,Bllacë,Budakovë etj,a mundemi para se me e dergu në Asamble me i kompletu të gjitha Shkollat që mos me na ardhë prap edhe një vendim tjetër ose a ka ndonjë arsye pse apo nuk ka persona adekuat.

Flamur Bytyçi- edhe mu po me duket shumë e pakuptim mbase veq ka ushtrues detyrë mos me i qitë të gjitha konkurset për me i emëru Drejtorat.

Avni Bytyçi-është një rregullore që i përcakton procedurat e formimit të komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve,Zëvendës Drejtorëve,Mësimëdhënëseve napër shkolla ,konkretisht neni 14 paragrafi 2 thotë DKA pas përfundimit të Konkursit në afat prej 3 ditësh e përzgjedh Komisionin për konkurset që jan shpallë jo me pretendimet për ushtrues detyre që ka nëpër Shkolla thot për konkursin qe u shpall DKA ka shpall konkurs për 6 pozita që jan në kuader të kësaj kërkesë që ju e keni para vetës dhe ne duke ju referuar rregullores ne kemi inicuar procedur për theelimin e komisionit dhe komisioni ka kompetencë dhe autoritet vetëm për këto pozita që jan këtu për me u përzgjedh dhe rregullorja thotë mandati i këtij Komisioni përfundon me përzgjedhjen e pozitive të Drejtorave.

Flamur Bytyçi-me sa po e kuptoj Avnien dhe me pas më të kuartë dhe unë,ky komision po formohet për pozitën që kan me u shpallë?

Avni Bytyçi-për pozitën që jan shpallë.

Sanie Kuqi Rexhepaj-atëherë pse nuk jan shpall konkurset edhe për Shkollat e tjera?

Laureta Tafaj-a është kompetence e plotë e Drejtorit për me i caktu dy anëtarët e komisionit apo,sepse ka pas raste në konkurset e më hershme kur kandidatët jan anku për anëtarët e komisionit dhe kan than që ne po merremi në intervistë nga njerëzit të cilët jan nivel më i ulët se ata që po konkurojnë.

Avni Bytyçi- rregullorja thotë dy përfaqësues vin nga DKA,një i punësuar në DKA që Kryetari i Komunës ka vlerësu dhe ka konsideru që Begishe Basha i plotëson kushtet dhe kriterët të jetë në kuadër të këtij komisioni dhe anëtar i dytë vjen po ashtu nga Dka i propozuar që duhet të jetë o anëtar i këshillit të prindërve të Shkollave o Drejtorë Shkolle me performancë të lartë dhe Kryetari i Komunës ka vlerësu që z.Jeton Vranovci i plotëson kriteret dhe e ka propozu anëtar të komisionit.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-si zakonisht ne kërkojmë gjithë përfshirje të partive politike në komision sepse u bë e pa drejtë tu shku napër komisione vetëm pozita në fjalë dhe kërkojmë gjithë përfshirje të anëtareve të Kuvendit.

Sanie Kuçi Rexhepaj-në mandatin e kalum dhe vetë prej anëtarëve të komisionit të atëhershëm dhe prej disa nxënësve kam ndëgju ankesa rreth rregullores,mënyrës së vlerësimit dhe pat dal edhe atëherë si propozim që rregullorja me u rishqyrtu dhe me u rregullu aty ku ka gabime dhe nuk e di pse nuk është sjellë rregullorja e plotësime e ndryshume ose rregullorja krejtësisht e re perderisa ka pas qaq shumë ankesa rreth asaj.Drejtori nuk është këtu por unë po e ndajë këtë shqetësim se kam qenë pjesë e Kuvendit në mandatin e kalum përderisa ka qenë ai shqetësim bile njëra nga anëtarët ka thënë që nuk kisha hy ma në këtë komision sepse kriterët bin ndeshë njëra me tjetrën,përderisa mënyra e vlerësimit nuk është korrekte atëherë pse shpërndajm bursa ku mundemi me bë diferenca jo të drejta ndaj këtyre nxënësve.

Laureta Tafaj-po du me u ndërlihdh me atë qfarë e tha Sania,në mandatin e parë kam qenë anëtarë e komisionit për ankesa,unë kam than që nuk marrë pjesë më asnjëherë në atë komision me të vertetë ka qenë i ndjehshëm,kriterët jan shumë të pa balancume mes vete,vjenë një nxënës që i ka dy prindër të vdekur dhe vjen në tjetër që të dy prindër i punojnë e merrë bursen komunale ai që i ka prindërit gjallë dhe i punojnë përshkak të disa pikëve,një ish kolege e jona që tash nuk është pjesë e Asamblesë ka kërku me u ndryshu rregullorja dhe e ka pru në Kuvend mirpo nuk është marrë për bazë ,ma mirë është për neve një ditë me u ulë me ndryshu këtë rregullore dhe me marrë bursën ata që duhen me marrë prej Komunës.

Dardan Berisha-rregullorja fillon me u ndryshu në momentin që përfundojnë bursat dhe tash është vonë edhe pse është mirë me propozu me u ndryshu sepse ka pa kënaqësi,por këtu në këtë projekt-vendim nuk po shkruan sa bursa kan me u nda për studentë dhe sa për nxënës?

Avni Bytyçi-qështja e përcaktimit të ndarjës së nr të bursave është kompetencë e Kryetarit,dhe ai përcakton me një vendim tjetër qështjen e ndarjës së bursave në bazë të planifikimit të buxhetit.

Mimoza Bajraktari-përshendetje për të gjithë,në mandatin e kalum kam qenë në komisionin për ankesa,fakultetet private automatikisht jan diskualifiku dhe ata që kan pas biznese,problemin kryesorë ku e kemi pas në dy raste,ku njërit nxënës i ka vdekë baba dhe nana nuk jetonë më me të por e rrit dikush tjetër dhe nuk mujke me marrë bursën pasi që atij i figurojke që nana punon sepse ajo është martu diku tjetër dhe ne në bazë të rregullores nuk kemi mujtë me i dhënë.

Flamur Bytyçi-nga njëher të qështja e rregullores pornnga njëher duhet edhe anëtarët e komisionit duhet me u mundu me gjetë zgjidhje,kur don me i kry punë dikujt.

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 6.Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Flamur Bytyçi-deshta me pytë Drejtoreshën tek kjo pjesa që po shpërndahet dhe që po shkon në obligime përveq kësaj tabele që jan tash të paraqitne si obligime,edhe sa obligime i kemi pa pagu si Komunë dhe te qështja tjetër instalimi dh ndriqimi publik në fshatra,në seeancën e kalume drejtori tha që jan në negociata për me shkëput marrëvshjen në kordinim me opratorin dhe në anën tjetër ju po kërkon mi bartë 236.000 dhe unë nuk po. Ekam të kjartë a ka kontrat apo e keni shkeputë dhe qka po doni me bo me këto mjete që po alokoni.

Erza Ramadani-përshendetje për të gjithë,për pjesën e obligimeve e kam adresu te ZKF sepse ai ka qasje për me i pa këto dhe më ka njoftu që para Asamblesë ka me e përgadit raportin dhe kemi me sjellë në Asamble,për pjesën tjetër besojë Drejtoria e Shërbimeve Publike e din.

Laureta Tafaj-sa prej ketyre mjetëve që po bartën po shkojnë në projektet të cilat jan kështu të përfunduara edhe sa po shkojnë në projekte të cilat i kan marrë përmbaruesit.

Erza Ramadani-janë të paraqitne në tabela,këto kan me shku për 2 projekte kapitale qysh janë të cekura te tabela nr 2,pjesa tjetër jan të ndara në kategori tjera mallra dhe shërbime.

Laureta Tafaj-brenda këtyre a kemi projekte që janë të përfunduara dhe këto mjete po bartën?

Erza Ramadani-për përfundimin e kontratave e dinë Drejtori i Shërbimeve Publike.

Laureta Tafaj-meqenëse nuk është Drejtori me na dhën një përgjigje e cila kishte me qenë pohuese atëherë unë jam kundër bartjeve të këtyre mjeteve sepse po shkojnë aty ku neve na prezantohen si të përfunduara.

Flamur Bytyçi-te këto projektet me bashkëfinancim nuk po e kam të qartë nëse mundet dikush me na elaboru pak më qartë.

Kryesuesi-bëhet fjalë për dy projekte me bashkëfinancim,një është për objektin e zjarëfikësave në Shirokë dhe një është ujësjellësi në Peqan.

Dardan Berisha-është më mir me qenë më konkretë tek projektet e shërbimeve publike dhe duhet me qenë Drejtori ktu për me ditë se ku po heziton.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 6

4 për,3 kundër,0 abstenim miratohet

Pika 7 Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin e komisionit për shqyrtimin e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjes “13 Qershori” ;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin.

Kryesuesi-pasi nuk ka debat e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për rishqyrtimin e vendimit 01-Nr-410-9873;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-para se me vendos ne këtë a nuk e kemi ditë që nuk është në përputhje me kompetencate aksionarëve apo tash është bë e re?

Avni Bytyçi-me hyrjen në fuqi të ligjit për paga i kam tregu edhe më herët as anëtarët e Asamblesë nuk lejohet më u kompenzu,dhe Ministria e ka kthi qata nga ndërmarrja publike nuk lejohet më dhe nëse doni nga Komuna me i marrë dhe i miratoni në Kuvend.

Flamur Bytyçi-tek qështja e komisionit ne kemi qenë në takim me shefat e grupeve që na ka ftu Kryetari lidhur me punën e Eko-Regjionit kam një pyetje për zyrtarin ligjor ky vendim po merret veq për qështjen e pagesave?

Avni Bytyçi-vetëm për qështjen e pagesave të komisionit.

Flamur Bytyçi-vendimi po më pëlqen ajo qka po më shqetëson është edhe qështja e raportimit ne edhe në të kalume kemi pas anëtarë të komisionit aksionarë mirpo asnjëher nuk kemi marrë raport se qka po ndodh me këtë ndërmarrje.

Sanie Kuçi Rexhepaj-në mandatin e kalum kam qenë unë anëtare dhe shumë herë e kam ngritë si shqetësim se si komision nuk jemi duke mbajtur takime në lidhje me ket raportimin për Eko-Regjionin,edhe në KPF edhe në Asamble e kam shpreh si shqetësim që nuk jan tu funksionu si Komision dhe një herë ju e patët marrë përsipër me na mbledhë neve anëtarëve dhe me fillu me zgjedh Kryesin për me vazhdu procedurat tjera,edhe kur është diskutu rregullorja e mbeturinave edhe atëherë e kam ngrit si qështje që drejtorja e shërbimeve publike ndonëse e ka hartu një rregullore të mbeturinave të re asnjëherë nuk e ka thirrë atë komision që me u konsultu para se me shku në Kuvend,leje që nuk kan mbajtur debat publik me qytetarët në mandatin e kalum por as me atë komision që ka dal nga Kuvendi kështu që nuk ka funksionu.

Enver Shabani-Komuna e Suharekës e ka një përfaqësues në bordin e Eko-Regjionit dhe ai. E ka një far obligimi dhe raporton kohë pas kohe sigurisht e dorzon një raport në shërbimet publike,ndoshta është defekt i shërbimeve publike që nuk e kemi delegu më tutje,ndoshta atë raport u desht me diskutu,nuk jam i sigurt një herë në 6 muaj apo një herë në vit nuk jam i sigurt por koh pas kohe kan dorëzu.

Laureta Tafaj-a mundem me dal me një kërkesë për Drejtorin e Shërbimeve publike për me i marrë të gjitha raportimet të cilat kan ardh nga Eko-Regjioni,duke i hulumtu ato ndoshta mundemi me ardh me një përfundim për këtë që është duke u mundu me na e bë zotëria në fjal Kryeshefi ekzekutiv për me na rrit tarifat.

Kryesuesi-e hedh në votim pikën 8

Unanimisht miratohet

Pika 9.Shqyrtimi i proejkt-vendimit për rishqyrtimin e vendimit 01-Nr-410-9874;

Kryesuesi-e elaboron dhe e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 10. Shfuqizimi i vendimit Nr-016-9866;

Kryesuesi-e elaboron dhe e hap debatin

Flamur Bytyçi-nuk po du me bë politik por ju si Ekzekutiv duhet me marrë përgjegjësi,ju keni desht me i dhën afat 1 vjet një kontrate që është e shkëputne kush ka qenë ky ekspertë,ju në zon e keni një raport dhe raporti po ju tregon ku duhet me marrë masa,ju i keni shkëput kontratat në Samadrexhë ku nuk ka as infrastruktur,as kanalizim as rrym dhe ju në zonë industriale nuk keni guxu asnjë kontratë me shkëput,aty kemi keq përdorim të kontratave dhe problemi është që ju po heshtni dhe nuk po merrni masa.

Sanie Kuçi Rexhepaj-realisht vendimin që jeni duke dashtë me shfuqizu tash e shoh si një paaftësi me i marrë përgjegjësit që të takojnë si Kryetar dhe si Ekzekutiv përshkak që ne si opozit në mbledhjen para dy seancave kur u diskutu qartazi me nene dhe ligje kam tregu që nuk është kompetencë e Kuvendit por i takon Komunës konkretisht Drejtorisë së Pronës dhe Zyrës së Kryetarit për me marrë vendime qfarë do qofshin ato,kështu që ka shumë më shumë si mënyrë qysh me dal Kryetari me thën që po ju shkëputi kontratën i ka ardhë pak si rënd sepse është i treti mandat dhe ajt tash po them që është vendim i Kuvendit dhe me këtë vendim po e shkëputim dhe kjo është me i ik përgjegjësis që i takon si Kryetar.Zona Industriale me të vertetë ka shumë probleme

dhe këtë e kemi pa në raportin që është dorëzuar sepse na ka dhënë një imazh të saktë të Zonës Industriale se qfar po ndodh sepse gjithmonë e kemi pas edhe një tjetër që është Zona që po funksionon më së miri në Kosovë. Tu i pa problemet edhe në atë mbledhje që është diskutuar un kompropozu edhe forma të zgjidhjeve, kam propozu edhe plan të veprimit duke u bazuar në raportin e komisionit përshkak se secila parcelë nuk e ka problematikën e njëjtë, kam propozu kategorizim të rasteve dhe marrjen e masave në bazë të kategorive e jo jepi një vit kohë për të plotësuar kontratën dhe ai nuk mundet pa ju dhënë mënyra të tjera, nuk jeni tu e marrë seriozisht këtë çështje, a jeni tu desht me e qitë në vi të ligjit të rregullave zonën industriale apo veq për sy e faqe që jemi duke ndër marrë diçka. Kjo çasje nuk është serioze.

Dardan Berisha-unë mendojë që duhet të formohet një komision i ri për trajtimin e Zonës Industriale në Shirokë dhe nuk e di a ka fillu Drejtori dhe Kryetari. Këto probleme nuk janë dy vitet e fundit por janë më të hershme dhe ne duhet me përcjllë në Kuvend.

Laureta Tafaj-unë këtu e shoh Kryetarin një frikacak i cili nuk ka qenë në gjendje me marrë një vendim që i ka taku në këtë aspekt, një vendim ku faktet ju kanë paraqit përpara i ka pas në dorë të gjitha dokumentet se qka po ndodhë dhe kjo është veq një frikë ndoshta prej atyre bizneseve qofshin familjare apo shoqërore dhe është mundu me gju të Asambleja por fatmirsisht që ekziston dikush tjetër që i ndan këto punë dhe ne nuk kemi nevoj me u marr më me të e shkëput kontratën ose jo është punë e Kryetarit

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika.11 Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2026;

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi: 11:30